

**LEDIA DUSHKU**

**KRYENGRITJET SHQIPTARE KUNDËROSMANE TË  
VITEVE 1910-1912 DHE KOMITETI BALLKANIK I LONDRËS**

**Turqit e Rinj dhe kryengritjet në viset shqiptare**

Kur Turqit e Rinj ngritën flamurin e Revolucionit në korrik 1908, nën parullën “Liri, barazi, vëllazëri”, ata nuk patën përkrahës më të zjarrtë sesa shqiptarët. Ndonëse arsytet e mbështetjes ishin të shumëllojshme dhe me ndryshime themelore mes tyre, shqiptarët e mirëpritën rivendosjen e Kushtetutës Osmane, duke e parë, disa si mbrojtëse të traditave, të tjerë si prelud të autonomisë kulturore e politike.

Pasi morën në dorë frenat e pushtetit, Turqit e Rinj menduan të vinin në jetë parullën e tyre. “Bashkimi osman” për ta nuk ishte gjë tjetër veçse bashkimi i të gjitha njësive etnike të Perandorisë, duke i dhënë fund të gjitha prirjeve separatiste për këdo, qofshin myslimanë ose jo<sup>1</sup>. Xhonturqit kërkonin kështu të centralizonin, të njësonin dhe të racionalizonin gjithçka. Ndërkohë u shpall doktrina e otomanizmit dhe u përcoll imazhi i unitetit dhe vëllazërisë. Në shtetin osman “nuk ka bullgarë, grekë, rumunë, çifutë apo myslimanë. Të gjithë jemi të barabartë. Të gjithë krenohemi që jemi osmanë”<sup>2</sup>.

Por, popujt dhe kombet e Perandorisë kishin një përfytyrim tjetër për “bashkimin osman”. Bashkimi për ta do të thoshte ruajtje dhe pse jo lulëzim i sistemit të autonomisë kulturore, në përputhje me të cilën, ata do të ishin në radhë të parë shqiptarë, grekë apo armenë dhe më pas osmanë, shtetas të Perandorisë. Si shpërblim për pjesëmarrjen në luftë kundër despotizmit, elita e tyre kërkonte të kishte shumë më tepër se një post shtetëror. Ajo kërkonte autonomi të zgjeruar duke nënkuptuar dhe

---

<sup>1</sup> *Historia e Perandorisë Osmane*, nën drejtimin e Robert Mantran, Tiranë: Dituria, 2004, f. 551.

<sup>2</sup> George Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja, Sundimi otoman, Islamizmi dhe Shqiptarët, 1874-1913*, Tiranë: Bota Shqiptare, 2007, f. 234.

ëndërruar pavarësinë<sup>3</sup>. Pjesa tjetër e popullsisë, shihte rastin që të ruante dhe të forconte traditat ekzistuese.

Vendosja e Kushtetutës jo vetëm që nuk i fashiti problemet kombëtare por i shtoi edhe më tepër ato. Pas shtypjes së Kundërrevolucionit të 13 prillit 1909, Turqit e Rinj vendosën të vinin në jetë pikëpamjet e tyre centralizuese, duke nxjerrë një varg ligjesh represive. Në gusht 1909, doli Ligji mbi Shoqatat, zbatimi i të cilit shpërndau shoqatat kulturore dhe mbylli klubet patriotike. Neni 4 i këtij ligji ndalonte “shoqatat politike, të cilat objektivin ose emrin e tyre e merrnin nga një racë apo kombësi”. Shpërbërja e çetave në territoret e njohura si Maqedoni dhe në viset shqiptare do të bëhej nëpërmjet vënies në jetë të Ligjit mbi ndalimin e çetave në Rumeli dhe Ligjit mbi Komitet. Parashikohej kryerja e shërbimit të detyrueshëm ushtarak edhe për popullsinë jo myslimane<sup>4</sup>. Ndërkaq dalja në vitin 1910 e Ligjit për Kishat<sup>5</sup> shqetësoi popullsinë e krishterë, në varësi të Patrikanës Ikumenike të Stambollit.

Turqit e Rinj menduan të ndiqnin edhe një politikë osmanizimi kulturor. Në funksion të saj u synua centralizimi i sistemit arsimor në Perandori. Fillimisht, ata u përpoqën të devijonin ecurinë e arsimit kombëtar, por pasi dështuan, vendosën ta asgjësonin krejtësisht atë. Sakaq, u krijua një inspektorat për shkollat jo turke dhe u kërkua të vendosej me detyrim gjuha turke si gjuhë zyrtare nëpër shkolla dhe gjykata. Gjatë vitit 1910, Shkolla Normale e Elbasanit dhe shkolla e djemve të Korçës u mbyllën. Të njëjtin fat pati edhe shtypshkronja shqiptare e Manastirit<sup>6</sup>. Shumë nëpunës, mbështetës të alfabetit latin u hoqën nga postet e tyre dhe u dërguan në Anadoll ose në provincat arabe. Në këtë shënjestër u vu edhe rrjeti bektashi, sepse për xhonturqit ai ishte ngushtësisht i lidhur me propagandën në favor të germave latine<sup>7</sup>. Gazetat shqiptare që sapo kishin filluar të dilnin u ndaluan dhe botuesit në shumë raste u burgosën pa gjyq. Gazeta e Shkodrës e vazhdoi botimin e saj edhe

<sup>3</sup> *Historia e Perandorisë Osmane*, nën drejtimin e Robert Mantran..., f. 551.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 552.

<sup>5</sup> Dritan Egro, “Lamtumirë Rumeli! Dorëzimi i Janinës, Greqisë (1913), një histori e dhimbshme osmane”, në: *Abedin Dino dhe çështja çame sot*, përgatiti për botim Ahmet Mehmeti, Tiranë: Arbëria, 2010.

<sup>6</sup> Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar- Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë: Përpjekja, 2009, f. 571.

<sup>7</sup> *Po aty*, f. 572.

për pak kohë, vetëm sepse artikujt politikë të saj nuk trajtonin problemet aktuale. Por më në fund edhe ajo dha shpirt sepse nuk i përshtatej “frymës së kohës”<sup>8</sup>. Qindra nacionalistë shqiptarë u arrestuan ose u detyruan të kërkonin strehim jashtë vendit<sup>9</sup>. Sipas studiuesit George Gawrich, në fund të vitit 1910, Shqipëria ishte kthyer në një djerrinë kulturore për patriotët shqiptarë<sup>10</sup>. Situata u rëndua edhe sepse Turqit e Rinj u përpoqën të impononin zgjidhje me anë të forcës, për vendosjen e rendit dhe të ligjit në viset veriore shqiptare.

Masat e marra shkaktuan zhgënjim e pakënaqësi jo vetëm tek shqiptarët, por edhe tek grekët, armenët, arabët e Sirisë, etj. Një pjesë e tyre u zhgënjye sepse Kushtetuta nuk u solli lirinë e shpresuar, mirëqenien materiale dhe zhvillimin e lirë kombëtar, të tjerë sepse ajo nuk u garantoj ruajtjen e traditave dhe privilegjeve të kamotshme. Por të gjithë bashkoheshin në një pikë: Regjimi i vjetër kishte qenë i keq, ndërsa i riu i padurueshëm. Si i tillë, ai nuk u kishte sjellë dhe nuk do t’u sillte asgjë të mirë.

Në përpjekje për të reaguar, përpara elitës politike shqiptare shtrohej si detyrë imediate, sensibilizimi i faktorit ndërkombëtar dhe sigurimi i mbështetjes për çështjen shqiptare. Përpjekjet e shqiptarëve gjenin pika takimi me punën e Komitetit Ballkanik të Londrës.

### **Pak fjalë për Komitetin Ballkanik të Londrës**

Komiteti Ballkanik i Londrës ishte themeluar në kryeqytetin britanik në vitin 1903, nën influencën e ngjarjeve që kishin ndodhur po atë vit në Maqedoni. James Bryce u zgjodh president i tij, ndërsa Noel Buxton, kryetar. Nën varësinë e tij vepronte Fondi i Ndihmës për Maqedoninë i krijuar po atë vit, me kryetar Bertram Christian<sup>11</sup>. Qëllimi kryesor i shprehur i Komitetit Ballkanik të Londrës ishte të arrinte një bashkëpunim mes vendeve ballkanike në dobi të një marrëveshjeje të përbashkët për të siguruar më shumë të drejta për popujt e rajonit, që

<sup>8</sup> Romeo Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*, Tiranë: UET-Press, 2012, f. 69.

<sup>9</sup> Joseph Swire, *Shqipëria ngritja e një Mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005, f. 94.

<sup>10</sup> G. Gawrych, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja...*, f. 278.

<sup>11</sup> Henry Woodd Nevinnson, *The fire of life*, London: James Nisbet & Co. Ltd, 1935, f. 141.

vijonin të ishin pjesë e Perandorisë Osmane<sup>12</sup>. Anëtarët e tij mbështesnin zbatimin e nenit 23 të Traktatit të Berlinit të 1878-ës, i cili sanksiononte zbatimin e rregullave organike të vitit 1868 në të gjitha pjesët e Turqisë Evropiane<sup>13</sup>. E kishin mirëpritur Revolucionin Xhonturk të 1908-ës, por shumë shpejt edhe ata si shumë të tjerë kishin zbuluar të vërtetën e hidhur: ndryshimi ishte vetëm në formë, por jo në natyrën e qeverisjes osmane<sup>14</sup>. Në vazhdimësi, Komiteti ishte përpjekur të luftonte sa më shumë të ishte e mundur, efektet negative të qeverisjes së Turqve të Rinj. Në këtë kuadër, ai synonte të ndikonte në objektivat e politikës së jashtme britanike, për ta bërë Ballkanin pjesë të agjendës së Londrës zyrtare.

Pavarësisht se çështja shqiptare nuk ishte në objektivat e drejtpërdrejta të punës së tij, në funksion të qëllimit të krijimit, Komiteti Ballkanik i Londrës kishte arsye të ishte aktiv edhe ndaj kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912. Është e vështirë të japësh në mënyrë shteruese kontaktet e shqiptarëve me të, sepse informacioni vazhdon të jetë jo i plotë. Për studiuesin Zef Prela, rumuni me origjinë shqiptare Albert Gjika, një ndër kandidatët për fronin e Shqipërisë në vitin 1913, punonte për Komitetin. Por, puna e tij nuk duket se ishte e besueshme për disa rrethe të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Nacionalistët shqiptarë, Dervish Hima, Nikolla Naço dhe përkrahësit e tyre në Bukuresht i kishin qëndruar larg si A. Gjikës, ashtu edhe Komitetit<sup>15</sup>. Ndërkohë që aktiv në kontaktet me këtë të fundit, veçanërisht gjatë Kryengritjes së vitit 1912 shfaqet Ismail Qemal Vlora. Studiuesja franceze Nathali Clayer pretendon se Komiteti Ballkanik i Londrës ishte në kontakte edhe me anëtarë të Komitetit shqiptar të Manastirit, të cilit i kishte ofruar mbështetje financiare në dobi të afrimit shqiptaro-bullgar<sup>16</sup>.

Në vitet e kryengritjeve shqiptare puna e Komitetit u përqendrua në dy aspekte kryesore: në sensibilizimin e opinionit publik britanik,

<sup>12</sup> *Balkanskiyat Komitet v London (1903-1946)*, Glavno Upravlenie na arhivite pri ministerskia съвет na Republika България. Nacionalien daritjelski fond “13 vjeka Bullgaria”, Universitjecko izdatjelsvo “Kliment Ohridski”, 2003, f. 275.

<sup>13</sup> Jusuf Buxhovi, *Kongresi i Berlinit, 1878, Çështja shqiptare, protokollet dhe vendimet*, Prishtinë: Faik Konica, 2008, f. 278.

<sup>14</sup> H. W. Nevins, *The fire of life...*, f. 274.

<sup>15</sup> Zef Prela, “Problemi shqiptar dhe politika austro-hungareze, 1897-1912”, në: *Mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë: Mihal Duri, 1962, f. 134.

<sup>16</sup> N. Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar...*, f. 514.

grumbullimin dhe shpërndarjen e ndihmave për malësorët dhe, në përpjekjet për organizimin e një kryengritjeje mbarëballkanike.

### **Sensibilizimi i opinionit publik, mbledhja dhe shpërndarja e ndihmave humanitare për malësorët shqiptarë**

Sensibilizimi i opinionit publik për çështjet ballkanike e veçanërisht atë maqedonase konsiderohej si një nga shtyllat e punës së Komitetit Ballkanik të Londrës. Duke synuar rritjen e ndjeshmërisë së opinionit publik e politik britanik në lidhje me reformat në Ballkan, anëtarët e tij në vazhdimësi kishin përgatitur memorandume, udhërrëfyes, kishin publikuar libra, rezoluta dhe mbajtur konferenca. Në memorandumin e parë të Komitetit Ballkanik të Londrës, përgatitur në vitin 1903, ndër të tjera shprehej dëshira për të siguruar autonominë e Maqedonisë dhe të Shqipërisë<sup>17</sup>. Me të drejtë në memorandumet vijuese, përgatitësit britanikë bënin me dije se shenjat e para të një revolte të hapur kundërosmane u shfaqën tek shqiptarët, të konvertuar në Islam, të cilët ishin përshkruar aq bukur në poezitë e Lordit Byron. Degjenerimi në një farsë i Kushtetutës Osmane, sulmi në shkolla, kisha dhe jetën komunitare të të krishterëve, ndalimi i gjuhës shqipe, represionet, brutaliteti dhe masakrat e osmanëve kishin demonstruar paaftësinë totale të Perandorisë<sup>18</sup>, arsye këto të qenësishme për t'i dhënë shkas reagimit në Ballkan.

Rolin kryesor në sensibilizimin e opinionit publik mbi kryengritjet në viset veriore shqiptare e luajti shtypi, ku krahas gazetave “Morning Post” apo “Near East”, shquhet e përditshmja britanike “The Times”, në faqet e së cilës u pasqyruan gjerësisht dhe dukshëm ngjarjet në Ballkan. Kjo jo rastësisht. Korrespondenti i gazetës për Ballkanin që prej vitit 1892, James Bouchier ishte anëtar i Komitetit Ballkanik të Londrës<sup>19</sup>. Edhe britanikja Edith Durham, anëtare e Fondit të Ndhmës për Maqedoninë<sup>20</sup>, pjesën dërrmuese të shkrimeve të saj i bëri publike në faqet e kësaj

<sup>17</sup> *Balkanskiat Komitet v London...*, f. 303. The Macedonian Committee. Autonomy proposals.

<sup>18</sup> *Po aty*, f. 350-352, Manifesto of the Balkan Committee, 12 tetor 1912.

<sup>19</sup> Keith Robbins, *Politicians, diplomacy and war in modern British history*, London: The Hambledon Press, 1994, f. 217; H. W. Nevins, *The fire of life...*, f. 279.

<sup>20</sup> Edith Durham, *Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë dhe shqiptarët* (ribotim), Tiranë: Naum Veqilharxhi, 1998, f. 336.

gazete. Durham kishte mbërritur në Shqipëri, në fillim të vitit 1904, nga Ohri. Që nga ajo kohë e kishte bërë “Vendin e Shqiptarëve” si shtëpinë e saj. Fillimisht e tërhequr nga dëshira për të mbledhur relike të simbolizmit parahistorik, si modele dielli që ende pikturoheshin në ballin e shumë grave shqiptare, apo zogj të vegjël në gurë e dru, që zbukuronin varret në rajone të caktuara<sup>21</sup>. Mirësia dhe bujaria, gatishmëria për të ndërmarrë çdo udhëtim, vullneti për të punuar ditë e natë që të lehtësonte sëmundjet dhe vuajtjet e malësorëve, pa anashkaluar guximin dhe ndershmerinë, kishin bërë që ajo të fitonte zemrat e shqiptarëve.

Nëpërmjet shkrimeve thuhet se të përditshme në faqet e “The Times” u dhanë informacione të plota dhe u përshkruan hollësisht kryengritjet në Kosovë e Malësi, veprimtaria e nacionalistëve shqiptarë ku spikat ajo e Ismail Qemal Vlorës, operacionet e ushtrisë osmane dhe u kundërshtua hapur politika osmane ndaj shqiptarëve<sup>22</sup>. Në përshtatje me situatën e

<sup>21</sup> H. W. Nevinston, *The fire of life...*, f. 275.

<sup>22</sup> Në lidhje me ngjarjet në viset veriore shqiptare shih: *The Times*, 11 shkurt 1911, p. 5, “The situation in Turkey”; *The Times*, 28 shkurt 1911, p. 5, “The King of Montenegro”, “The situation in Albania”; *The Times*, 18 mars 1911, p. 5, “The condition of Albania. Concentration of Turkish troops”; *The Times*, 31 mars 1911, p. 5, “Montenegrin Assurances”; *The Times*, 29 mars 1911, p. 5, “Fighting between Albanians and Turks”; *The Times*, 3 prill 1911, p. 5, “The rising in Albania”; *The Times*, 6 prill 1911, p. 5, “The Albanian rising”; *The Times*, 7 prill 1911, p. 5, “The Albanian rising”; *The Times*, 8 prill 1911, p. 5, “Turkey and the Montenegrin frontier”; *The Times*, 11 prill 1911, p. 5, “Extension of the movement”; *The Times*, 12 prill 1911, p. 5, “Heavy Turkish Losses”; *The Times*, 13 prill 1911, p. 5, “The Albanian rising”; *The Times*, 20 prill 1911, p. 3, “Montenegro and refugees”; *The Times*, 17 prill 1911, p. 5, “Further fighting round Tuz”; *The Times*, 21 prill 1911, p. 3, “The Turkish movement checked”; *The Times*, 24 prill 1911, p. 5, “Reserve to Turkish troops”; *The Times*, 25 prill 1911, p. 5, “The Albanian rising”; *The Times*, 26 prill 1911, p. 5, “Turkish politics”; *The Times*, 27 prill 1911, p. 5, “Turkish repulse in Albania”; *The Times*, 1 maj 1911, p. 5, *The fighting in Albania*; *The Times*, 2 maj 1911, p. 5, “The fighting in Albania”; *The Times*, 3 maj 1911, p. 5, “Conflicts on Montenegrin frontier”; *The Times*, 16 maj 1911, p. 5, “Turkish operation resumed”; *The Times*, 18 maj 1911, p. 5, “The Turkish operations in Albania”; *The Times*, 20 maj 1911, p. 7, “Conflicting reports”; *The Times*, 22 maj 1911, p. 7, “Position taken and petaken”; *The Times*, 30 maj 1911, p. 7, “Fighting in Albania”; *The Times*, 1 qershor 1911, p. 5, “The Turkish operations in Albania”; *The Times*, 3 qershor 1911, p. 5, “Turkish success in Albania”; *The Times*, 8 qershor 1911, p. 5, “Difficulties of the Turkish campaign”; *The Times*, 10 qershor 1911, p. 5, “Continued fighting”; *The Times*, 10 qershor 1911, p. 7, “Terms to the

krijuar, Komiteti përcaktonte si qëllime themelore të punës së tij mbledhjen e fakteve dhe ndërhyrjen nëse ishte e nevojshme për të vënë rregullin në territoret osmane<sup>23</sup>. Për këtë arsye, anëtarët e tij zhvilluan vizita në terren dhe organizuan takime me përfaqësues të elitës politike shqiptare dhe popullsinë vendase. Në një letër të shkruar nga Edith Durham në një fshat kufitar të Malit të Zi, më datë 11 qershor 1911, letër që u bë e njohur në gazetën “The Times” nëpërmjet sekretarit të Komitetit Ballkanik të Londrës, A. G. Symonds, ndër të tjera informohet se: “Shqipëria e Epërme është tani një shkretëtirë e mjerë. Të gjitha gratë dhe fëmijët, të cilëve me pak përjashtime u janë djegur shtëpitë, duke qenë aq të pafuqishëm për të ikur, janë duke gjetur strehim këtu. Ata iu larguan dhunimit dhe fyerjes, por tani janë përballë vdekjes nga uria. Në këtë distrikt janë 2.144 persona, ndërsa në gjithë Malin e Zi rreth 20.000 vetë”<sup>24</sup>.

Në thirrjen për ndihmë, botuar në të përditshmen “The Times” të datës 31 korrik 1911, nën titullin “Pikëllim në Shqipëri”, Komiteti Ballkanik i Londrës i drejtohej “përkrahjes bujare dhe simpatisë së popullit britanik që të ndihmojë për të shpëtuar nga uria dhe shfarosja, një racë trimë”. Me anën e thirrjes, i bëhej me dije opinionit publik e atij politik britanik se “...gjithë banesat e malësorëve gjatë operacioneve janë bombarduar ose janë djegur. Rrënimi është i plotë, vendi i shkatërruar”, fakte këto të vërtetuara nga shumë vëzhgues në terren duke përfshirë edhe zonjën Durham. “Në pranverë- shkruante ajo - nuk janë bërë mbjelljet e të lashtave dhe kjo gjë mund të bëhet shkas për një zi të bukës në një shkallë thuajse të përgjithshme. Mjerimi është shumë i madh, një vend i vogël dhe i varfër, që edhe sikur të ishte pjellor nuk ka burime të tilla që të mund t’i mbajë ata për një kohë të gjatë. Po kështu ndodh edhe në

---

insurgents”; *The Times*, 14 qershor 1911, p. 7, “Views of Ismail Kemal Bey”; *The Times*, 16 qershor 1911, p. 5, “Torgut Shevket’s army”; *The Times*, 17 qershor 1911, p. 7, “Insurgents and the Turkish promises”; *The Times*, 19 qershor 1911, p. 29, “Strong rebel resistance”; *The Times*, 29 qershor 1911, p. 5, “Turkish policy in the rebel distrikt”; *The Times*, 4 korrik 1911, p. 5, “Destruction of catholic villages”, “A region of desolation”.

<sup>23</sup> *Balkanskiyat Komitet v London...*, f. 348.

<sup>24</sup> R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914...*, f. 184.

kufijtë e distrikteve në Bregmatje dhe Shalë, për të cilët janë prerë të gjitha ndihmat”<sup>25</sup>.

Situata tejet e vështirë në viset veriore shqiptare për shkak të Kryengritjes së vitit 1911 dhe padyshim gjendja e rënduar e malësorëve zgjoi ndjenjat humanitare të britanikëve. Ata iu përgjigjën thirrjes për ndihmë të Komitetit Ballkanik të Londrës, në të cilin kërkoheshin të holla për të ndaluar vdekjen e afro 25.000 njerëzve nga uria. Shpërndarja e saj do të bëhej nga Fondi i Ndihmës për Maqedoninë, përfaqësues të së cilës kishin mbërritur në viset veriore shqiptare<sup>26</sup>. Ndihmat, të cilat llogariteshin në disa mijëra sterlina, do t’u jepeshin të gjithë nevojtarëve pa marrë parasysh qëndrimin politik dhe besimin e tyre<sup>27</sup>.

Propaganda për aksionin e shpërndarjes së ndihmave i dedikohet korrespondentit të gazetës “The Times” për Ballkanin, J. Bouchier, ndërsa shpërndarja e tyre në terren, dy prej anëtarëve të Fondit të Ndihmës për Maqedoninë, britanikëve Henry W. Nevinson dhe Edith Durham<sup>28</sup>. Duke qenë njohëse shumë e mirë e terrenit dhe e psikologjisë së malësorit, Durham, e quajtur prej tyre “Krajlica\Mbretëresha”, ndihmoi në mënyrë energjike në shpërndarjen e shpejtë të ndihmave. Sipas burimeve austriake, aksioni i ndihmës i Komitetit Ballkanik të Londrës u krye me ndërmjetësinë e konsullatës britanike, e cila ishte në akord të plotë me Londrën zyrtare që tregohej e gatshme t’i plotësonte

<sup>25</sup> *Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien* (më tej: *HHSSt.A.PA.A*) në: *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 21-20-2036, Thirrje për ndihmë e Komitetit Ballkanik të Londrës, Londër, 29 korrik 1911.

<sup>26</sup> *Po aty*, Vj. 21-7-752, Raport nga ambasadori austro-hungarez në Londër për ministrin e Punëve të Jashtme, Londër, 4 gusht 1911; H. W. Nevinson, *The fire of life...*, f. 275.

<sup>27</sup> Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ndihmave në Veri shih: *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 21-20-2036, Thirrje për ndihmë e Komitetit Ballkanik të Londrës, Londër, 29 korrik 1911; Vj. 21-7-752, Raport nga ambasadori austro-hungarez në Londër për ministrin e Punëve të Jashtme, Londër, 4 gusht 1911; Vj. 21-6-619, Raport i konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Shkodër për ministrin e Punëve të Jashtme, Shkodër, 9 shtator 1911; Vj. 21-6-629, Raport nga konsullata e Përgjithshme e Austro-Hungarisë në Shkodër për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 5 tetor 1911.

<sup>28</sup> *Archivio Storico e Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri* (më tej: *ASDMAE*), Serie Politica “P” (1891-1916), Albania, Pacco 673, Pos. 844, Anno 1911, Raport i konsullit të Përgjithshëm italian në Shkodër për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 12 shtator 1911.

këto dëshira<sup>29</sup>. Një ndihmesë të veçantë për blerjen e ndihmave dhe transportimin e tyre dha konsulli britanik në Trieste, zoti J. R. Spence<sup>30</sup>.

Ndihmat kishin të bënin kryesisht me sigurimin e ushqimeve, veshmbathjeve, batanijeve, lëndëve drusore për ndërtimin e shtëpive të djegura dhe vetëm një pjesë e vogël do të jepej në të holla. Pas inspektimit që ishte bërë prej të dërguarve të Komitetit, mendohej se në Hot, Grudë, Traboin, Kastrat dhe Bajzë do të ndërtoheshin 250 baraka për strehim. Për këtë qëllim, ishte blerë në treg e gjithë gjendja ekzistuese e dërrasave, ndërsa pjesa tjetër ishte porositur në Trieste<sup>31</sup>. Po ashtu ishte planifikuar të bëhej edhe shpërndarja e drithërave për popullsinë e vobektë, e cila ushqej kryesisht me barishte. Porosi të mëdha ishin bërë për kininë, ndonëse popullsia nuk i njihte medikamentet dhe vazhdonte të besonte tek simbolet pagane për t'u kuruar. Vetëm në Bregmatje u shpërndanë 50 kuti<sup>32</sup>. Për kurimin e njerëzve të sëmurë pritej të mbërrinte edhe një mjek britanik.

### **Komiteti Ballkanik i Londrës në përpjekje për organizimin e një kryengritjeje ballkanike**

Pasojat e përbashkëta të politikës centralizuese të Turqve të Rinj ishin një premisë e mirë që popujt e kombet e shtypur në Perandori të ishin bashkë për ta kundërshtuar atë. Përpjekjet për të organizuar një kryengritje mbarëballkanike nisnin në vitin 1911. Dokumentacioni austro-hungarez bën me dije se kishte bisedime mes grekëve dhe bullgarëve për

---

<sup>29</sup> *HHSSt.A.P.A.A në AIH*, Vj. 21-6-619, Raport i konsullit të Përgjithshëm të Austro-Hungarisë në Shkodër për ministrin e Punëve të Jashtme, Shkodër, 9 shtator 1911.

<sup>30</sup> H. W. Nevinson, *The fire of life...*, f. 275.

<sup>31</sup> *HHSSt.A.P.A.A në AIH*, Vj. 21-6-629, Raport nga konsullata e Përgjithshme e Austro-Hungarisë në Shkodër për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shkodër, 5 tetor 1911.

<sup>32</sup> H. W. Nevinson, *The fire of life...*, f. 278. Sipas tij: “Në fshatin Sumë, mbizotëronte mizerja dhe njerëzit hanin bar. Ne premtuam 10 thasë misër, që ata do të duhej të shkonin ta merrnin në Shkodër. Këtë veprim e bënë gratë, të cilat i transportuan thasët me misër në shpinë, në shpatet e pjerrëta. Më vonë shpërndamë kininë në mesin e fshatarëve të goditur nga ethet e malaries për shkak të kënetës helmuese në Mat. Në një fermë në Gursi, familja mbrohej nga “djalli” me kafkat e kuajve dhe cjapeve, disa prej të cilëve të gozhduar në kryq. Në Bregmatje gjetëm rreth 1000 vetë në ethe. Gratë i trajtuam në kuzhinë sepse kishin turp të trajtoheshin në sytë e burrave. Shpërndamë 50 kuti me kininë”.

një aksion të përbashkët, pa shmangur shqiptarët, bashkëpunim ky që përcaktohej si fatal për ekzistencën e Perandorisë Osmane<sup>33</sup>. Aktiv në këtë lëvizje ishte Ismail Qemal Vlora, i cili mbështeste planin për një kryengritje të përbashkët në Ballkan nën patronazhin e Britanisë së Madhe. Sipas projektit parashikohej që Greqia, Bullgaria, Serbia dhe Malit i Zi, në bashkëpunim me nënshtetasit turq që ishin fis me to dhe me shqiptarët t'i shpallnin luftë Perandorisë Osmane. Kryengritja shqiptare e Malësisë së Madhe, aktivizimi i Malit të Zi, agjitacioni serb, planet e kooperimit midis shqiptarëve dhe bullgarëve, afrimi politik i Greqisë dhe Bullgarisë shiheshin si preludi i aksionit të lart skicuar<sup>34</sup>. Por përpjekjet rezultuan të pasuksesshme.

Gjatë vitit 1912, puna e Komitetit Ballkanik të Londrës u përqendrua në kontaktet me opozitën osmane. Në rast se ajo merrte pushtetin, Komiteti përmbushte qëllimin e krijimit të tij, sepse opozita osmane në pikën e dytë të programit kishte formuluar parimin e autonomisë së provincave kombëtare, respektin për të drejtat e pakicave etnike dhe decentralizimin e shtetit osman, duke ruajtur ndërkohë, unitetin e tij politik<sup>35</sup>. Programi i partisë opozitare u mbështet edhe nga një pjesë e elitës politike shqiptare dhe asaj ballkanike<sup>36</sup>. Për këtë arsye, Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 iu dha vëmendje maksimale.

Në relacionin e 25 marsit të vitit 1912 dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Guvernatori i Austro-Hungarisë në Zarë pretendonte se kryengritja shqiptare, që pritej të shpërthente, do të ishte më e fortë se herët e tjera. Forca e saj, sipas raportshkruesit, lidhej nga njëra anë me veprimtarinë e mirëorganizuar të shqiptarëve, nga ana tjetër me aksionin e Komitetit Ballkanik të Londrës në vilajetet e Rumelisë. Ky i fundit po bëhej gjithnjë e më intensiv, pasi Komiteti kishte shpërndarë të holla dhe armë te vendasit. Llogaritej që në viset veriore të kishin hyrë rreth 12.000

---

<sup>33</sup> *HHSSt.A.PA.A* në *AIH*, Vj. 21-59, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë në Manastir për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Manastir, 15 prill 1911; Vj. 21-7-712, Raport nga sekretari i konsullatës austro-hungarez në Janinë për ministrin e Punëve të Jashtme, Janinë, 20 prill 1911.

<sup>34</sup> *Po aty*, Vj. 21-13-1374, Raport nga zëvendëskonsulli i Austro-Hungarisë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Vlorë, 25 maj 1911.

<sup>35</sup> G. Gawrich, *Gjysmëhëna dhe Shqiponja...*, f. 290.

<sup>36</sup> *Arhiv Vneshnjohj Politiki Rossi* (më tej: *AVPR*), Koleksioni i dokumenteve ruse që ndodhen në *AIH*, R. 29, Ambasada e Rusisë në Stamboll për Departamentin e parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, 22 janar 1912.

pushkë të markave bashkëkohore<sup>37</sup>. Nga ana tjetër, Komiteti Ballkanik i Londrës ishte duke punuar me të gjitha fuqitë që të realizonte sa më parë bashkimin e çetave bullgare, serbe dhe greke, me ato shqiptare<sup>38</sup>.

Kontaktet e shqiptarëve me drejtuesit e Komitetit Ballkanik të Londrës i mbajti Ismail Qemal Vlorë Qëndrimi i tij bashkëpunues me Komitetin vinte për një sërë arsyesh.

Pikëpamjet e pinjollit të Vlorajve mbi të ardhmen politike të shtetit osman përputheshin me misionin që kishte Komiteti Ballkanik i Londrës. Ai i përkiste atij grupimi të politikës osmane, i cili pretendonte që Fuqitë e Mëdha duhej të ishin aktive në reformimin e Perandorisë, si një garanci për të ndërmarrë reforma të efektshme. Për të, Perandoria Osmane duhej të ishte një bashkim kombesh nën flamurin e Kushtetutës, e cila duhej t'i garantonte secilit prej tyre ekzistencën e vet kombëtare<sup>39</sup>.

Ndihma në armë dhe të holla që Komiteti i Londrës kishte dhënë për kryengritjet në vitin 1910-1911<sup>40</sup> dhe vendi i veçantë që ai pritej të kishte në organizimin e një Konference Ndërkombëtare, e shtynin gjithashtu Ismail Qemal Vlorën të realizonte takime me anëtarët e tij<sup>41</sup>.

Mbajtja e Konferencës kishte kohë që diskutohej në kancelaritë e Parisit, të Londrës dhe të Petersburgut. Tematika e saj pritej të përqendrohej jo vetëm në Luftën Italo-Osmane, e cila nga shtatori i vitit 1911 mbante të ngërthyer opinionin ndërkombëtar, por edhe në reformat e brendshme që duhej të ndërmerrnin Turqit e Rinj për ta bërë më të durueshëm regjimin e tyre<sup>42</sup>. Kjo situatë konsiderohej prej Ismail Qemalit dhe Qendrës Shqiptare në Nicë, premtuese, por njëkohësisht edhe si e rrezikshme për Shqipërinë. Nëse shqiptarët nuk do të njihnin rëndësinë e saj, ata do të ishin të humbur përgjithmonë dhe nuk do të kishin kurrë më shpresë që të ngjallehin e të rronin si shqiptarë. Në këto kushte puna u përqendrua në dy çështje. *Së pari*, në sigurimin e të gjitha mjeteve për

<sup>37</sup> *HHS.A.P.A.A në AIH*, Vj, 22-6-662, Raport i guvernatorit të Austro-Hungarisë në Zarë për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Zarë, 25 mars 1912.

<sup>38</sup> *Po aty*.

<sup>39</sup> G. Gawrich, *Gjysmëhëna dhe shqiponja...*, f. 220-223.

<sup>40</sup> Z. Prela, "Problemi shqiptar dhe politika Austro-Hungareze...", f. 134.

<sup>41</sup> *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare (1910-1912)*, Përgatiti për botim Nevila Nika, Instituti i Historisë, Prishtinë: 2003 f. 218. Letër e Fazil Toptanit për Sotir Kolean, Nicë, 13 maj 1912.

<sup>42</sup> Raymond Poincaré, *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913)*, Logos: Prishtinë, 2006, f. 35, 38, 45.

kryengritësit shqiptarë dhe *së dyti*, në përgatitjet për “Kuvendin Evropian” që pritej të mbledhej, në të cilin Ismail Qemali shpresonte se do të diskutohej edhe çështja shqiptare<sup>43</sup>. Për të dyja çështjet kontaktet me Komitetin Ballkanik të Londrës merrnin rëndësi të veçantë.

Mesazhe inkurajuese për kontakte, pinjulli i Vlorajve kishte marrë edhe nga kryeministri grek, Eleftherios Venizelos, i cili në maj të 1912-ës me anën e Luigj Gurakuqit këshillonte bashkëpunimin me Komitetin e Londrës, për të siguruar armë dhe të holla për Kryengritjen Shqiptare<sup>44</sup>.

Në fund të qershorit të vitit 1912, Ismail Qemali së bashku me drejtuesin e opozitës osmane, Myhtar Pashën, mbërritën në kryeqytetin britanik, ku zhvilluan një takim edhe me drejtues të Komitetit Ballkanik të Londrës. Sipas dokumentacionit austro-hungarez, takimi kishte përfunduar me premtimin për t'i dhënë Ismail Qemal Vlorës një post të rëndësishëm në qeverinë që itilafistët<sup>45</sup> do të krijonin nëse vinin në pushtet. Gjithashtu, ishte rënë dakord që katër përfaqësues të opozitës osmane të zhvillonin bisedime në Londër me qarqet drejtuese britanike<sup>46</sup>. Nga sa më sipër të krijohet përshtypja se bisedimet, përpos të tjerave, i garantonin Britanisë së Madhe një pozitë të privilegjuar në Perandori, në rast se opozita osmane merrte pushtetin.

Vizita në Londër dhe takimet atje ndikuan në qëndrimin e Ismail Qemalit në lidhje me zgjerimin e Kryengritjes. Në një letër dërguar mbështetësve të tij diku nga mesi i korrikut të vitit 1912, ai udhëzoi se “Kryengritja duhet të organizohet e të vazhdohet sipas një plani dhe njerëzit duhet të mbledhen në male. Një luftë me trupat osmanë, pa u dhënë sinjali për një kryengritje të përgjithshme, të evitohet sa të jetë e mundur. Vendimi përkatës do të jepet shumë shpejt, por duhet pritur edhe disa ditë nëse edhe parlamenti do të ketë po atë fat që pati edhe qeveria xhonturke. Sa u përket mjeteve të nevojshme për kryengritjen si: para, armë, municione etj., po ashtu edhe për personin e princit të Shqipërisë së ardhshme, nuk duhet të shqetësohet njeri, mbasi një shtet i fuqishëm të

<sup>43</sup> *Përmbledhje dokumentesh mbi kryengritjet shqiptare...*, f. 221-222. Letër e Ismail Qemalit, Luigj Gurakuqit dhe Fazil Toptanit për Pleqësinë e Shoqërisë Shqiptare në Egjipt, Nicë, 25 maj 1912.

<sup>44</sup> *HHSt.A.PA.A në AIH*, Vj. 22-12-1290, Letër e Fazil Toptanit për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Paris, 24 maj 1912.

<sup>45</sup> Me këtë emër njiheshin anëtarët e partisë opozitare osmane.

<sup>46</sup> *Po aty*, Vj. 22-12-1286, Relacion për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë (Informacion mbi letrën e Fazil Toptanit), 29 korrik 1912.

cilin nuk dua që ta cilësoj hollë, do të qëndrojë mbas këtij aksioni”<sup>47</sup>. Ka shumë gjasa që “shteti i fuqishëm” i përmendur në letër, të ishte Britania e Madhe. Ismail Qemali i përkiste atij grupimi politikanësh osmanë, të cilët vazhdimisht kishin kërkuar dhe shpresuar në përkrahjen dhe mbështetjen e Britanisë së Madhe<sup>48</sup>.

Por sa e interesuar ishte realisht Mbretëresha e Deteve ndaj Ballkanit dhe a mundi të influencojë Komiteti Ballkanik i Londrës në politikëbërjen britanike?

Sipas studiuesit Keith Robbins, në terma të përgjithshëm, opinioni publik historikisht ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në politikëbërjen britanike. Shtetarët britanikë nuk kanë hezitur të shprehen se në Britani opinioni publik ishte suprem në çështje të rëndësishme<sup>49</sup>.

Pas turbullirave të vitit 1903 në Maqedoni dhe Shqipëri, Britania e Madhe propozoi një program radikal reformash në Maqedoni dhe ushtroi presion politik mbi Sulltanin për më shumë të drejta për popujt e Ballkanit. Ndonëse interesi i saj për çështjet ballkanike u shfaq i kamufluar në kuadrin e Çështjes Lindore, dalëngadalë ajo u largua nga politika “*splendit isolation*” duke marrë pjesë më aktive në ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha në Ballkan. Nënshkrimi në gusht të vitit 1907 i konventës midis Britanisë së Madhe dhe Mbretërisë së Rusisë, konventë kjo që plotësoi formimin e Antantës, zbehu konsideratën që Perandoria Osmane kishte për Mbretëreshën e Deteve. Ajo nuk u konsiderua më “mikja më e mirë” e Stambollit, i cili filloi të kërkonte mbështetje gjetiu. Gjermania paraqitej si një mundësi e mirë për të. Lidhja turko-gjermane u forcua dukshëm dhe në fund të dekadës së parë të shek. XX, Gjermania zotëronte një ndikim të konsiderueshëm financiar e ushtarak në Perandorinë Osmane. Tashmë ajo ishte fuqia e madhe e përzgjedhur nga Stambolli për të patur një rol të rëndësishëm në reformimin e ushtrisë osmane. Pjesëmarrja në blloqe të ndryshme acaroi marrëdhëniet mes

<sup>47</sup> *Po aty*, Vj. 22-1-122, Raport i konsullit të Austro-Hungarisë për zonën Vlorë-Berat për ambasadorin perandorak mbretëror të Austro-Hungarisë në Stamboll, Berat, 26 korrik 1912.

<sup>48</sup> Gazmend Shpuza, *Në vazhden e gjurmimeve për epokën e Rilindjes Kombëtare (Përmbledhje shënimesh historike dhe historiografike)*, Tiranë: Toena, 1997, f. 105.

<sup>49</sup> K. G Robbins, “Public opinion, the press and the pressure groups”, në: *British Foreign policy under sir Edward Grey*, Edited by Francis Harry Hinsley, London: Cambridge University Press, 1977, f. 70.

Britanisë e Gjermanisë, acarim ky që u shpreh edhe në rivalitetin mes palëve për të siguruar pozita dominuese në Stamboll.

Në këtë kuadër, Komiteti Ballkanik i Londrës do të luante një rol të rëndësishëm, edhe për faktin se sekretari britanik i Punëve të Jashtme, Edward Grey, publikisht kishte mbështetur krijimin e tij<sup>50</sup>. Në fjalimet e tij ai çmonte influencën e opinionit publik, madje shpesh herë e paraqiste atë si vendimtar në hedhjen e hapit përfundimtar. Në Britaninë e Madhe ndonëse revoltat shqiptare konsideroheshin një çështje e brendshme e shtetit osman dhe për sa kohë ato do të ishin të tilla çdo ndërhyrje ishte e padëshirueshme, vlerësohej se nuk mund të lejohej përkeqësimi i situatës, i cili do të sillte një kërcënim të madh për paqen në Evropë. Qëndrimi britanik dhe personalisht ai i Grey-t, lidhet edhe me sqarimet e hollësishme dhe të vazhdueshme që diplomacia britanike kishte marrë nga burime të tërthorta, në radhë të parë nga Edith Durham<sup>51</sup>. Një telegram alarmant kishte mbërritur edhe nga gazetari William Thomas Stead. Nga Vjena, ai i shkruante sekretarit të Jashtëm britanik: “Në qoftë se ju nuk veproni në mënyrë të menjëhershme me anë të ultimatimit të fuqishëm, turqit do të shfarosin 40.000 shqiptarë, ashtu sikurse vranë të gjithë kafshët në Kostandinopojë, nëpërmjet lënies pa ushqim. Shefqet Turgut Pasha e ka shprehur në mënyrë të qartë dhe të prerë vendosmërinë e tij për t’i shfarosur shqiptarët, së pari nëpërmjet rrethimit të 16.000 burrave, grave dhe fëmijëve paqësorë, të përqendruar në moçalet e malaries, derisa ata të vdesin prej etheve, dhe së dyti, nëpërmjet lënies së uritur të kryengritësve të mbetur derisa të vdesin ndër male. Situata është tmerrësisht serioze: vetëm një veprim i menjëhershëm prej jush mund të shmangë tmerret më të këqija se tmerri i Bullgarisë së vitit 1876. Zgjatja e armëpushimit është vetëm në të mirë të lojës së Turgut Pashës. Krimi më i neveritshëm i mundshëm do të jetë në dyert e Evropës në qoftë se ju nuk veproni menjëherë”<sup>52</sup>.

Nga ana tjetër, standardi i zhvillimit dhe i konceptimit të lirive dhe të drejtave themelore njerëzore në Britaninë e asaj kohe ishte i lartë. Për klasën politike britanike ishte e papranueshme dhunimi sistematik i të drejtave dhe lirive më elementare njerëzore, siç po ndodhte me malësorët shqiptarë. Më 27 korrik 1911, në një diskutim më Dhomën e Komuneve,

<sup>50</sup> *Balkanskiyat Komitet v London (1903-1946)*., f. 329.

<sup>51</sup> R. Gurakuqi, *Shqipëria 1911-1914*., f. 309.

<sup>52</sup> *Po aty*.

kryetari i Komitetit Ballkanik të Londrës, Noel Buxton u shpreh se situata shqiptare ishte “problemi më urgjent” para tyre. Në mbështetje të tij, po atë ditë e në të njëjtën foltore sekretari britanik i Punëve të Jashtme do të fliste për situatën e rënduar humanitare në Shqipëri dhe për rrezikun që turbullirat shqiptare mund të krijojnë për ndjeshmërinë e vendeve fqinjë<sup>53</sup>.

Në përfundim mund të themi se ngjarjet në Ballkan në përgjithësi e ato në Maqedoni e Shqipëri në veçanti rigjallëruan interesin publik për fatet e Perandorisë Osmane. Propaganda e Komitetit Ballkanik të Londrës luajti një rol të rëndësishëm në këtë aspekt. Ai arriti të sensibilizonte opinionin politik dhe atë publik britanik në lidhje me kryengritjet në Shqipëri dhe gjendjen e vështirë humanitare aty, por pa mundur t’i bënte bashkë aktorët dhe faktorët politikë në Ballkan, duke dështuar në përpjekjet e tij për organizimin e një kryengritjeje mbarëballkanike, një ndërmarrje kjo që realisht ishte jashtë mundësive të tij.

### *S u m m a r y*

#### THE ALBANIAN UPRISINGS AGAINST THE OTTOMANS FROM 1910-1912 AND THE BALKAN COMMITTEE OF LONDON

As part of the Albanian political elite’s endeavors to react promptly to the centralizing policy of the Young Turks, making aware the international factor and ensuring its support for the Albanian cause was considered of immediate importance. In this context, the attempts of Albanians matched with the activity of the Balkan Committee of London.

The Balkan Committee of London was founded in the British capital in 1903, influenced by the events of that same year in Macedonia. The main aim of this Committee was to achieve cooperation among Balkan countries in order to come to an agreement which would ensure more rights for the region’s peoples that were still part of the Ottoman Empire. Although the Albanian cause was not a direct concern of its activity, the Balkan Committee of London was active in relation to the Albanian uprisings of 1910-1912. The Committee focused its work on two aspects: in raising the awareness of the British public

---

<sup>53</sup> J. Swire, *Shqipëria ngritja e një Mbretërie...*, f. 100.

opinion, gathering and delivering aid for the Albanian mountaineers of the northern regions, and the organization of a Balkan uprising.

Due to an intensive awareness campaign the Balkan Committee of London raised the public and political interest in Britain concerning the fate of the Ottoman Empire. The Committee had been successful in making British aware of the uprisings in Albania and the difficult humanitarian situation there. However, it had failed in its attempts to join the Balkan political actors in organizing a pan-Balkan uprising, an undertaking well beyond its reach.